



Tiranë, 2014



Ky projekt zhvillohet në kuadër të programit “Të njohim më mirë Bashkim European - rruga e integritit të Shqipërisë në BE “. Qëllimi i projektit është prezantimi i BE-së tek nxënësit e arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Realizimi i tij u bë i mundur nga stafi i Qendrës Europiane, me mbështetjen e çmuar të Fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri, i cili financoi projektin.

Për të dhëna të mëtejshme në lidhje me Bashkimin European dhe integrimin e Shqipërisë në BE mund të drejtoheni tek:

Qendra Europiane

Rr. “Vaso Pasha”,

P. 20, Ap. 57

Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 451 9076

www.euro-centre.eu

Fondacioni Konrad Adenauer

Blv. “Dëshmorët e Kombit”

Kulla Binjake 1, Kati 11, A3

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 66 525

<http://www.kas.de/albanien>

Botues: “EDLORA”

ISBN: 978-9928-4201-4-5

Design & Layout: Dritan Lleshi

GUIDË MBI INSTITUCIONET E BASHKIMIT EUROPIAN



Botim i Qendrës Europiane dhe Fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri

Tiranë, 2014

“Europa nuk mund të bëhet me një të goditur,
as edhe në një ngrehinë të vetme: ajo do të
bëhet me anë realizimesh konkrete duke
krijuar më së pari një solidaritet faktik”

ROBERT SCHUMAN, 9 MAJ 1950



“Bashkimi (i funksioneve ekonomike) do të
detyrojë shtetet të shndërrojnë sovranitetin e
tyre në atë të një shteti të vetëm europian”

JEAN MONNET, 3 PRILL 1952

“Plani i Schuman-it dhe Traktati janë vetëm fillimi.
Kjo është një nismë e vetëm gjashtë shteteve
europiane, e cila një ditë do të shndërrohet në
bashkimin e të gjithë Europës”

KONRAD ADENAUER, 20 KORRIK 1952



A e dini se?	5
I. NË FILLIM	
1.1 Si lindi Bashkimi European?	7
1.2 Historiku i të gjithë traktateve	8
1.3 Valët e zgjerimit	10
II. TË EKSPLOROJMË EUROPËN	
2.1 Parlamenti European	12
2.2 Këshilli European.....	14
2.3 Këshilli (i Ministrave) i BE-së.....	15
2.4 Komisioni European.....	16
2.5 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European	18
2.6 Gjykata e Llogarive.....	18
2.7 Banka Qendrore Europiane.....	19
III. “MADE IN EU”	
3.1 Tregu i Përbashkët European.....	20
3.2 Euro-zona	22
VI. RRUGA JONË DREJT BE-së	
4.1 Historiku i Marrëdhënieve Shqipëri - BE.....	23
4.2 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)	25
VI. PYETËSOR	26
Referenca.....	28



A e dini se?

Komunitetin
European e krijuan
6 shtete

Parisi është
kryeqyteti
më i madh i
BE-së

Shteti më i
madh në BE
është Franca

Hapat e para
të Bashkimit
European u
hodhën në 1957

Në BE jetojnë
rreth 500 milionë
njerëz, ndërsa
në Europë
857 milionë

Flamuri i BE - së ka
12 yje, si simbol i
përsosmërisë,
në fushë blu

Dita e Europës
është data
9 Maj

Shteti që kufizohet
me më shumë shtete
në BE dhe Europë
është
Gjermania

Bashkimi
European ka
28 shtete
anëtare

Shteti me
popullsinë më të
madhe në BE është
Gjermania

Monedha e
përbashkët europiane,
që përdoret
në 18 vende
është "EURO"

Europa e ka
marrë emrin e saj
nga një princeshë
e mitologjisë
greke

Gjuhët
zyrtare në
BE janë 24

Himni i Bashkimit
European është
"Ode to Joy" i
Bethoven

1.1 Si lindi Bashkimi European?

Në 9 maj të vitit 1950, Robert Schumann, atëherë ministër i punëve të jashtme të Francës hodhi idenë e krijimit të Bashkimit European. Ai propozonte një Europë federale të ngjashme me "Shtetet e Bashkuara të Europës", që do të realizohej përmes bashkimit ekonomik dhe shoqëror të popujve.

Jean Monnet, bashkëpunëtor i Schumanit dhe një nga themeluesit e BE-së shkruante: "Ne nuk bashkojmë shtetet, por bashkojmë njerëzit". Procesi i bashkimit do të ishte i gjatë dhe i vështirë, por aspak i pamundur.



1.2 Historiku i të gjithë traktateve

1. Hapi i parë nisi me Krijimin e **Komunitetit Europian të Qymyrit dhe të Çelikut**, nga **Traktati i Parisit**, që u nënshkrua më 18 prill 1951. Gjashtë shtete u bënë pjesë e këtij Traktati, por me ç'dukej ai nuk i përmbushte të gjitha synimet për krijimin e një Europë të bashkuar, vetëm përmes qymyrit dhe çelikut. Bashkëpunimi duhej të zgjerohej dhe në fusha të tjera të ekonomisë.




2. Hapi i dytë, ishte nënshkrimi i **Traktatit të Romës**, më 25 mars 1957, që krijoi Komunitetin Ekonomik Europian dhe Komunitetin Europian për Energjinë Atomike (Euroatom) zgjeroi bashkëpunimin ndërmjet shteteve sidomos në krijimin e Tregut të përbashkët europian.


Ndryshimet politike, që ndodhën në Europën e viteve '80, rënia e komunizmit dhe fillimi i procesit të demokratizimit në Europën Lindore e Qendrore, rënia e murit të Berlinit dhe bashkimi i "dy" Gjermanive, lëvizjet masive emigruese nga Lindja drejt Perëndimit, shtruan para Komunitetit Europian nevojën e një bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme e si rrjedhim hartimin dhe nënshkrimin e një traktati të ri.

3. Traktati i Mاستriht-it i nënshkruar më 7 Shkurt 1992 themeloi Bashkimin Europian si një organizatë të re rajonale, që u bazua mbi tri shtylla kryesore:

Tri Shtyllat e BE-së



Shtylla e Parë
Bashkëpunim ligjor - komunitar



Shtylla e Dytë
Politika e jashtme &
Siguria e Përbashkët



Shtylla e Tretë
Bashkëpunimi në punët
e brendshme dhe drejtësi

Ky Traktat parashikoi bashkimin ekonomik e monetar dhe monedhën e vetme, Euron.

4. Traktati i Amsterdimit, i nënshkruar në 17 qershor 1997, përveç ndryshimeve në strukturat e BE-së, rriti bashkëpunimin e shtyllës II dhe III, përfshiu në BE Marrëveshjen Shengen të vitit 1995.

Lëvizja e lirë e qytetarëve, u shndërrua në një realitet të prekshëm vetëm pas krijimit të **“zonës Shengen”**. Kjo zonë pa kufij e ka marrë emrin nga vendi ku u nënshkrua marrëveshja, Shengen Luksemburg. Aktualisht në të nuk marrin pjesë Mbretëria e Bashkuar, Irlanda apo vendet e reja anëtare, megjithëse dy vende jo anëtare të BE-së – Norvegjia dhe Islanda - janë pjesëtare. Në zonën Shengen, shtetasit e BE-së dhe vizitorët e huaj janë të lirë të udhëtojnë sipas dëshirës, pa iu nënshtruar kontrolleve sistematike të pasaportave. Gjithsesi, vendet anëtare ruajnë të drejtën të rivendosin kontrollin në kufij për një periudhë të kufizuar kohe në rrethana të jashtëzakonshme. Heqja e kontrolleve të brendshme kufitare e bën më të lehtë për qytetarët që zbatojnë ligjin të lëvizin lirshëm në Europë.


5. Traktati i Nisës i nënshkruar më 26 shkurt 2001, nën Presidencën franceze, Objektivi i të cilit ishte reformimi i institucioneve me qëllim që BE të funksionojë me efikasitet dhe pas zgjerimit të tij.

6. Kushtetuta Europiane ishte një projekt për të ndërtuar një konfederatë shtetesh europiane. Ajo u firmos në Romë në 29 tetor 2004, por u refuzua pas rezultatit negativ të referendumeve popullore në Francë dhe Holandë.


7. Traktati i Lisbonës u miratua nga 27 shtete anëtare të BE-së në 17 dhjetor 2007. Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës në 1 dhjetor 2009 solli ndryshime të rëndësishme në arkitekturën kushtetuese të BE-së, duke zgjeruar dhe kompetencat dhe funksionet e disa institucioneve të Bashkimit.

Traktati i ri e theksoi dhe fuqizoi më shumë natyrën sipër-kombëtare të sistemit. Shtetet Anëtare vendosën të mos t`a tkurrin zonën e diskrecionit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Për më tepër, Shtetet Anëtare vendosën t`a shtrijnë me tej juridiksionin e zakonshëm të kësaj Gjykate për çështje, që më parë i përkisnin shtyllës së tretë të komunitetit dhe deklaruan për herë të parë se e pranonin supremacinë e praktikës gjyqësore të kësaj Gjykatës së Luksenburgut.


Traktati i Lisbonës në një vështrim të shkurtër



1.3 Valët e zgjerimit



INSTITUCIONET E BASHKIMIT EUROPIAN



2.1 Parlamenti European

Parlamenti European (PE) është i vetmi institucion i zgjedhur drejtpërdrejt nga popujt e shteteve anëtare të Bashkimit European. Eurodeputetët përfaqësojnë në PE zërin e qytetarëve të të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, PE-së iu shtuan kompetencat ligjvënëse, të ndara sipas grupimeve politike. Aktualisht PE përbëhet nga 766 eurodeputetë. Numri i tyre për çdo vend është i ndarë në varësi të numrit të popullsisë së shteteve anëtare. Shteti me më shumë eurodeputetë është Gjermania me 99, ndërsa numrin më të vogël të eurodeputetëve e mbajnë Estonia dhe Luksemburgu me 6 të tillë. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës asnjë vend nuk mund të ketë më pak se 6, ose më shumë se 96 eurodeputetë.

Misioni i PE-së është:

- përfaqësimi i qytetarëve europianë;
- diskutimi rreth çështjeve të rëndësishme për ta;
- debati dhe miratimi i ligjeve europiane (PE është bashkëligjvënës);
- kontrolli i institucioneve të tjera të BE-së;
- debati dhe miratimi i buxhetit të BE-së.

Vendimet e marra në Parlament nga eurodeputetët ndikojnë drejtëpërdrejt tek qytetarët europianë.

➤ **Procesi ligjberës i PE-së**

Parlamenti punon së bashku me Këshillin e BE-së për të vendosur mbi përmbajtjen dhe miratimin zyrtar të ligjeve të BE-së. Ky proces quhet "Procedurë e Zakonshme Legjislative". Pushteti i PE është rritur ndjeshëm me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës.



PE zhvillon veprimtarinë e tij në:

Bruksel (Belgjikë)

Mbahen mbledhjet e Komiteteve.

Luksemburg (Luksemburg)

Është selia e zyrave administrative.

Strasburg (Francë)

Mbahen mbledhjet e PE.

➤ **Mbikëqyrja demokratike**

PE ushtron kontroll mbi aktet e Këshillit të BE-së dhe Komisionit të BE-së.

Në rastet kur emërohet përbërja e re e Komisionit, 28 anëtarët e tij (një përfaqësues për secilin shtet) nuk marrin detyrën deri në çastin, që PE bën miratimin. Gjithashtu, PE ka të drejtë të thërrasë Komisionerët për të dhënë dorëheqjen gjatë mandatit të tyre, procedurë kjo që njihet si “Mocioni i Censurës”.

Gjithashtu, kontrolli i Komisionit kryhet përmes monitorimit të raporteve. Kontrolli mbi Këshillin e BE-së bëhet kryesisht në lidhje me bilancin vjetor.

➤ **Mbikëqyrës i buxhetit**

PE së bashku me Këshillin European miraton buxhetin e BE-së. Kjo procedurë zhvillohet duke formuar një komitet monitorues mbi faktin sesi është shpenzuar buxheti. Gjithashtu, diskutohet dhe mbi mirë përdorimin e tij krahasuar me buxhetin e vitit pararendës.

2.2 Këshilli European

Këshilli European është pjesë e rëndësishme e “zonjës” Europë. Ky institucion filloi veprimtarinë në vitin 1974 si një forum ku diskutonin liderët e shteteve anëtare në BE. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës Këshilli European u bë zyrtarisht një ndër institucionet e Bashkimit European. Ai përbëhet nga presidentët ose kryeministrat e të gjithë vendeve anëtare në Bashkimin European, Presidenti i Komisionit European dhe Presidenti i Këshillit të Ministrave të BE-së.

Presidenti i këtij institucioni është z. Herman Van Rompuy.

Mbledhjet mbahen çdo gjashtë muaj në **Bruksel**.

Funksioni i Këshillit:

Qëllimi kryesor i funksionimit të Këshillit European është hartimi i politikave dhe veprimtarive të BE-së. Ky institucion nuk ka fuqi ligjvënëse. Vendimet në Këshillin European merren me konsensus, përveç rasteve kur Traktati i Lisbonës parashikon ndryshe.

2.3 Këshilli i Ministrave i BE-së

Këshilli i Ministrave të BE-së, quhet kryesisht “Këshilli” dhe përbëhet nga ministrat e jashtëm të çdo vendi anëtar, duke siguruar kështu pjesëmarrjen e qeverive kombëtare në procesin vendimmarrës të BE-së.

Funksionet e Këshillit janë:

- Miratimi i ligjeve të reja të BE-së të propozuara nga Komisioni Europian (bashkëligjvënie me PE-në);
- Bashkërendimi i politikave ekonomike;
- Krijimi i më shumë vendeve të lira pune;
- Përmirësimi i politikave për sistemin e edukimit, të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare si përfaqësues i BE-së;
- Miratimi i buxhetit vjetor të BE-së (bashkëkompetencë me PE);
- Kujdesi për çështjet e drejtësisë.

Këshilli e ka selinë e tij qendrore në **Bruksel**.

KUJDES!!! Këshilli i Ministrave të Bashkimit Europian nuk duhet ngatërruar me Këshillin Europian dhe Këshillin e Europës.




2.4 Komisioni European

Komisioni European (KE) është një nga 3 institucionet më kryesore të BE-së. Ai përbëhet nga një komisioner për çdo vend anëtar, të cilët caktohen nga Këshilli. Emërimi i komisionerëve miratohet nga PE.

Çdo komisioneri i caktohet nga Presidenti, përgjegjësia për fushat e politikave të veçanta. Presidenti aktual i KE është Jose Manuel Barroso, i cili u mandatua për të dytën herë në Shkurt 2010.

KE ka detyrë të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e BE-së si një organizëm i tërë. Ky institucion shpesh njihet si “motorri i BE-së”.



Funksionet më kryesore të Komisionit:

➤ **Propozimi i ligjeve të reja**

Komisioni ka të "drejtën e iniciativës ligjore", ai mund të propozojë ligje të reja për të mbrojtur interesat e BE-së dhe të qytetarëve të saj. Këto propozime bëhen vetëm për çështje, që nuk mund të trajtohen në mënyrë efektive në nivel kombëtar, rajonal ose lokal duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit.

➤ **Menaxhon buxhetin e BE-së dhe ndarjen e fondeve**

KE vendos për 'kornizën financiare' të BE-së. Ai harton një buxhet vjetor dhe mbikëqyr se si janë shpenzuar fondet e BE-së nga autoritetet kombëtare dhe rajonale. Gjithashtu, KE menaxhon fondet për politikën e BE-së (p.sh. bujqësia dhe zhvillimi rural) dhe për programe të tilla si "Erasmus" (shkëmbime studentore).

➤ **Zbatimi i ligjit të BE-së (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë)**

KE njihet edhe si një "roje i së drejtës europiane". Në rast se një shtet anëtar nuk zbaton Rregulloret dhe Direktivat e BE-së, atëherë Komisioni i dërgon letër zyrtare në mënyrë, që shteti të marrë masa për të korrigjuar problemin.

➤ **Përfaqëson BE-në ndërkombëtarisht**

KE flet në emër të të gjitha gjuhëve të vendeve anëtare duke e paraqitur Bashkimin European në nivel ndërkombëtar. KE mbron interesat e të gjithë Unionit si një i tërë. Nga ana tjetër, ai merr përsipër detyrimet ndërkombëtare për makrostrukturën europiane.

KE zhvillon aktivitetin e tij në:

Bruksel dhe në Luksemburg

ku ndodhen selitë e tij;

Në çdo vend të BE-së

ku ndodhen zyrat e përfaqësimit; dhe

Në disa kryeqytete të botës

ku ndodhen Delegacionet e KE.



2.5 Gjykata Europiane e Drejtësisë

Gjykata Europiane e Drejtësisë (GjED) është hallka më e lartë e sistemit gjyqësor në BE. Ajo përbëhet nga një gjyqtar për secilin vend anëtar. Veprimtaria e GjED-së ndihmohet nga 9 avokatë të përgjithshëm, të cilët japin mendime ligjore lidhur me çështjet e paraqitura në gjykatë. Avokatët japin opinionet e tyre në mënyrë publike dhe të paanshme. Çdo gjykatës dhe avokat i përgjithshëm emërohet me një marrëveshje të përbashkët të shteteve anëtare dhe ka një mandat 6 vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Funksionet më kryesore të GjED-së:

- Siguron respektimin e traktateve të BE-së;
- Interpreton Rregulloret dhe Direktivat e BE-së;
- Zgjidh mosmarrëveshjet ligjore midis qeverive të vendeve anëtare dhe institucioneve të BE-së;
- Mbron të drejtat e qytetarëve europianë në rastet kur ata pretendojnë se u janë shkelur të drejtat nga institucionet e BE-së.

Gjykata e Drejtësisë njihet në gjuhën e përditshme edhe si **Gjykata e Luksemburgut**, për shkak të vendndodhjes së saj.

2.6 Gjykata e Llogarive

Në organet ndihmëse të përbashkëta ka rëndësi të veçantë Gjykata e Llogarive e hyrë në funksion në 1977, që shqyrton llogaritë e Komunitetit dhe të çdo organizmi të ngritur nga ai duke kontrolluar që të hyrat dhe të dalat të jenë të ligjshme dhe të rregullta. Në traktatin e Maastrichtit ajo bëhet "institucion i Komunitetit", pra organ kryesor në të njëjtin rang si Parlamenti, Këshilli etj. Ngritja e Gjykatës pasqyron vullnetin e qeverive për të ndjekur një transferim cilësor të kontrollit financiar "të jashtëm", sidomos për shkak të bilancit të rritur komunitar. Vendodhja e saj është në Luksemburg.

2.7 Banka Qendrore Europiane (BQE)


Banka Qendrore Europiane, u themelua në 1 qershor 1998 dhe nisi të funksionojë në vitin 1999. BQE është institucioni monetar i BE-së duke pasur një rol mjaft të rëndësishëm pas hyrjes në qarkullim të Euro-s. Banka ka komunitet ekzekutiv, të përbërë nga Presidenti, zëvendës-presidenti dhe katër anëtarë, të zgjedhur. Këshilli drejtues është i përbërë nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe 18 guvernatorët e bankave qendrore të shteteve anëtare që përdorin Euron.

Funksionet kryesore të BQE-së:

- Të mbajë çmime të qëndrueshme, sidomos në vendet që përdorin Euron;
- Të mbajë të qëndrueshëm sistemin financiar, duke monitoruar Tregun e Përbashkët;

Banka Qendrore së bashku me gjithë guvernatorët e shteteve anëtare formon Sistemin Europian të Bankave Qendrore. Ky bashkëpunim ka marrë emrin "Eurosistem".

Selia e saj ndodhet në **Frankfurt**.




3.1 Tregu i Përbashkët European

Shtetet anëtare të BE-së kanë synuar qysh prej krijimit të saj: Zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, dhe një rritje të standardit të jetesës. Për të arritur këto objektiva duhet të plotësoheshin dy kushte:

1. Hapja e kufijve, duke lejuar njerëzit, mallrat dhe shërbimet të lëvizin lirisht brenda Bashkimit European.
2. Bashkëpunimi midis shteteve anëtare duke krijuar politika të përbashkëta dhe instrumente financiare.

Pra, nocioni Treg i Brendshëm, hapësira pa kufij të brendshëm, është i mbështetur në 4 liri kryesore:

1. *Liria e qarkullimit të mallrave* nënkupton:
 - heqjen e pengesave doganore;
 - heqjen e pengesave fiskale;
 - bashkëpunimin doganor.
2. *Lëvizja e lirë e personave* iu referohet:
 - punëtorëve me kontratë;
 - punëtorëve të pavarur;
3. *Lëvizja e lirë e shërbimeve* njih mundësinë:
 - e dhënies së një shërbimi;
 - e kryerjes së një veprimtarie në një shtet tjetër, në të njëjtat kushte me profesionistët vendas, por jo në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme.



4. Lëvizja e lirë e kapitaleve përfshin:

- qëndrueshmërinë e parasë dhe kapitaleve;
- liberalizimin e pagesave;
- liberalizimin e tregut të sigurimeve;
- krijimin e tregut të përbashkët për shërbimet financiare.

Tarifat dhe detyrimet doganore u hoqën prej korrikut 1968. Si treg i vetëm u deklarua "i arritur" në 1 janar 1993. Pas kësaj në 1986 u nënshkrua Akti Unik Europian, duke caktuar hapat e nevojshëm për plotësimin e Tregut të Përbashkët Europian. Duhet pasur parasysh, që nëse mallrat, shërbimet, njerëzit dhe para ja të lëvizin lirisht brenda këtij tregu, duhet të ketë rregulla që sigurojnë konkurrencën e ndershme.




Arritjet:

- Tregjet kombëtare të vendeve janë hapur, falë rregullave të forta dhe kontrolleve në ofertën publike dhe kontratat e punëve.
- Pabarazitë midis sistemeve kombëtare të taksave janë zbutur përmes disa rregullave të përbashkëta të taksimit jo të drejtpërdrejtë.
- Tregjet e parasë dhe shërbimeve financiare janë liberalizuar.
- Harmonizimi i ligjeve të vendeve lidhur me sigurinë dhe ndotjen e vendeve të BE-së.
- Barrierat që pengojnë lëvizjen e lirë të personave janë hequr.

3.2 Euro-zona

Nevoja për një monedhë të përbashkët u ndie kur Europa filloi të përparonte në krijimin e tregut të përbashkët. Një treg në të cilin lëvizin lirisht mallrat, personat, shërbimet dhe kapitalet nuk mund të funksiononte në mënyrën e duhur pa një monedhë të përbashkët. Nga hedhja e idesë për një monedhë të vetme europiane në Traktatin e Mاستrihtit deri në realizimin e saj, u desh një periudhë 10 vjeçare. Më 1 Janar 2002 në vendet e Bashkimit European filloi të qarkullojë monedha e vetme europiane "EURO". Euroja ka zëvendësuar monedhat, e 18 vendeve anëtare. Kjo monedhë u ka dhënë qytetarëve të BE-së një gjykim më të qartë mbi identitetin e përbashkët europian. Këto vende formojnë të ashtuquajturën "Euro-Zonë". Shtetet e tjera anëtare përdorin si mjet këmbimi monedhat e tyre kombëtare. Megjithëse ka vetëm 12 vjet në qarkullim Euro është monedha e dytë më e rëndësishme në botë.



04

RRUGA DREJT BASHKIMIT EUROPIAN

4.1 Historiku i Marrëdhënieve Shqipëri-BE

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE-së e kanë zanafillën e tyre në vitet '90. Hapat kryesore të kësaj rruge janë:

1991	Vendosen marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe Bashkimit European
1992	Nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Përfitimi nga Programi PHARE.
1997	Përfaqsjja Rajonale për vendet e rajonit, ku vendet që duan të bëhen pjesë e BE-së, duhet të plotësojnë disa kushte politike dhe ekonomike.



1999	BE propozon procesin e Stabilizim Asociimit, për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi Shqipërinë.
Qershor 2000	Vendet e Stabilizim Asociimit janë kandidatë potencialë për anëtarësimin në BE, përfshi Shqipërinë.
Nëntor 2000	Fillimi i Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.
Janar 2003	Hapen negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asociimit mes Shqipërisë dhe BE-së.
Shkurt 2006	Mbyllen Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.
Maj 2006	Hyn në fuqi Marrëveshja ripranimit Shqipëri-BE.
Qershor 2006	Nënkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. (MSA)
Janar 2007	Hyn në fuqi instrumenti i Ri i Asistencës financiare të para-aderimit (IPA).
Janar 2008	Hyn në fuqi marrëveshja e lehtësimit të vizave mes Shqipërisë dhe BE-së.
1 Prill 2009	Hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.
28 Prill 2009	Shqipëria paraqet kërkesën për anëtarësim në BE.
8 nëntor 2010	BE miraton vendimin për liberalizimin e vizave me Shqipërinë.
Dhjetor 2010	Hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e zonës Shengen (Schengen).
Dhjetor 2011	Plani i Punës për antarësimin e Shqipërisë në BE, plotësimi i rekomandimeve.
Tetor 2012	Komisioni Europian rekomandon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.
Tetor 2013	Në Strategjinë e Zhvillimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014, Komisioni rekomandon se, meqenëse Shqipëria ka arritur progresin e nevojshëm, Këshilli duhet t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat.
Dhjetor 2013	BE refuzon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, duke e shtyrë këtë vendim për në vitin 2014.

Integrimi i Shqipërisë, e cila nuk është ende pjesë e BE-së, nënkupton, përafrimin e vlerave themelore mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe jeton ky organizëm i madh ndërshtetëror. Këto vlera, ose siç njihen ndryshe kriteret e Kopenhagës janë:

- *Kriteri Politik* - Demokracia, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, etj.
- *Kriteri Ekonomik* - Ekonomi funksionale tregu, e aftë për ti bërë ballë konkurrencës brenda BE-së.
- *Përafrimi i legjislacionit* të vendit tonë me atë të BE-së.

4.2 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)

Stabilizimi dhe Marrëveshja përbëjnë kuadrin e marrëdhënieve midis Bashkimit Europian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, për zbatimin e procesit të stabilizim-asociimit. Marrëveshjet janë përshtatur me situatën specifike të çdo vendi partner, duke vendosur objektiva të përbashkëta politike, ekonomike, tregtare si dhe inkurajimi i bashkëpunimit rajonal. MSA ofron mundësinë për bashkëpunim dypalësh dhe zgjeron futjen e mallrave pa tarifa doganore të shtetit nënshkrues në tregjet e BE-së. Marrëveshja synon dhe bashkëpunimin rajonal, për të forcuar dhe lidhur vendet ballkanike. Përfitimet nga kjo marrëveshje janë në fushën e tregtisë dhe një hyrje më të lirë të prodhimeve vendase si dhe marrja e burimeve financiare, për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, rrugëve etj.



Testoni njohuritë tuaja mbi Bashkimin European


Gjeni fjalën që mungon

1. _____ janë institucionet kryesore të BE-së.
2. Strasburgu është në _____.
3. _____ propozon ligjet e reja në BE.
4. _____ vendos nëse shtetet anëtare kanë shkelur ligjet e BE-së.
5. Institucionet e BE-së ndodhen në _____, _____ dhe _____.
6. Qytetarët e BE-së zgjedhin Parlamentin European çdo _____ vjet.
7. Presidenti i Komisionit European është _____.
8. Shteti me më shumë Eurodeputetë është _____.
9. "Baballarët" e Bashkimit European konsiderohen _____ dhe _____.
10. _____ përcakton agjendën e përgjithshme të politikave të BE-së.

Cili është rezultati juaj?

- **Nëse i jeni përgjigjur saktë 1-3 pyetjeve:**
Jo keq! Radhën tjetër duhet të tregohesh më i/e vëmendshëm/shme kur lexon!
- **Nëse i jeni përgjigjur saktë 4-7 pyetjeve:**
Urime! Ti di shumë për BE-në. Bëjuani këto pyetje familjarëve tuaj dhe zbuloni nëse ata mund të përgjigjen!
- **Nëse i jeni përgjigjur saktë 8-10 pyetjeve:**
Perfekte! Ti nesër mund të përfaqësosh denjësisht Shqipërinë në BE!





REFERENCA

Bianku, L. (2002). Guidë mbi Organizatat Kryesore Ndërkombëtare. Tiranë: Qendra Europiane.

Bianku, L. (2007). Bashkimi Europian (Përmbledhje Traktatesh). Tiranë: Qendra Europiane .

Bianku, L. (2007). Leksione të së Drejtës Europiane. Tiranë: Qendra Europiane.

Canaj, E. & Bana, S. (2011). E drejta e Bashkimit Europian. Tiranë: UET Press.

Paskal, F. (2007). Europe in 12 lessons. Brussels: European Comission.

http://europa.eu/about-eu/institutions-bodies/index_en.htm

http://europa.eu/kids-corner/index_en.htm

<http://www.buzzle.com/articles/interesting-facts-about-europe.html>

<http://www.mie.gov.al/>

ISBN: 978-9928-4201-4-5



9 789928 420145